



KOMISIONI RREGULLATOR  
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË  
UJIT  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT



## NJOFTIM PËR OPINIONIN

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit mori vendim, me të cilin bëhet rritja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 0,04 % në raport me vendimin e datës 12.07.2021.

Kjo rritje e çmimeve në bursat botërore e ka arritur nivelin, me të cilin u plotësuan kushtet për uljen e akcizës për 2,00 denarë për litër për EURODIZELIN (D-E V), në përputhje me Dekretin me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e ligjit të akcizave gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 dhe të Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1) rriten për 0,50 denarë/litër.

Çmimi i shitjes me pakicë i EURODIZELIT (D-E V), ulet për 2,00 denarë/litër, në raport me çmimin e shitjes me pakicë, të përcaktuar me vendimin për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse për transport, nga data 12.07.2021, kështu që çmimi i shitjes me pakicë i EURODIZELIT (D-E V) është 61,00 den/ litër.

Çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU rritet për 0,299 den/kg dhe tani do të jetë 38,018 den/kg.

Nga data 20.7.2021, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

Benzinë për motorë	EUROSUPER BS - 95	72,50 (denarë/litër)
Benzinë për motorë	EUROSUPER BS -98	74,50 (denarë/litër)
Naftë për motorë	EURODIZEL BS (D-E V)	61,00 (denarë/litër)
Vaj për Djegie	Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	63,50 (denarë/litër)
Mazut M-1 SU		38,018 (denarë/kilogram)

Në periudhën e kaluar shtatëditore të gjitha çmimet referente në bursat botërore, mesatarisht shënojnë rritje edhe atë: te benzina për 1,717 %, te nafta për 0,886 %, te vaji ekstra i lehtë për 1,285 % dhe të mazuti për 1,197%.

Në të njëjtën periudhë kursi i denarit në raport me dollarin është më i ulët për 0,123%.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 20.7.2021. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT dhe EUROSUPER BS – 95 në Maqedoninë e Veriut dhe disa vende të BE-së ([https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin\\_en](https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en) datë 12.7.2021) janë dhënë në tabelën në vijim në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të RMV-së [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk).



Tabela 1. Çmimet e shitjes me pakicë të Eurodizelit dhe Eurosuper BS-95

	Eurodizel (EUR)	EUROSUPER BS-95 (EUR)
Maqedonia e Veriut	1,023	1,169
Austria	1,245	1,307
Bullgaria	1,127	1,127
Kroacia	1,392	1,453
Gjermania	1,392	1,603
Greqia	1,388	1,674
Italia	1,508	1,650
Hungaria	1,255	1,259
Sllovenia	1,294	1,250

12.7.2021